



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

RAPORTI I PLANIT TË INTEGRITETIT INSTITUCIONAL
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
(JANAR-QERSHOR 2025)

Prishtinë,
Korrik, 2025

Përmbajtja

I. Përmbledhje ekzekutive	1
II. Analiza e realizimit të planit të integritetit	1
III. Realizimi i aktiviteteve	2
IV. Sfidat	3
V. Rekomandime	3

I. Përmbledhje ekzekutive

Në Kosovë autoriteti më i lartë për shëndetësi, Ministria e Shëndetësisë (MSH) në pajtim me legjislacionin në fuqi për parandalimin e korrupsionit, ka përgjegjësinë kryesore për të krijuar politika dhe për të bërë monitorimin e zbatimit të këtyre politikave, që kanë ndikim në parandalimin e korrupsionit potencial dhe sjelljeve tjera jo - profesionale në sektorin e shëndetësisë.

Në këtë drejtim, MSH ka hartuar dhe miratuar Planin e integritetit për periudhën 2025 -202, i cili plan ofron masa të mbështetura te rreziku për të arritur objektivat e integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Përmes këtyre politikave e veçanërisht përmes zbatimit të Planit të Integritetit Institucional, Ministria e Shëndetësisë ka shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet duke synuar, që të arrijë të zvogëlojë rrezikun nga korrupsioni respektivisht rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës në të gjithë sistemin shëndetësor përfshirë edhe menaxhimin dhe shpenzimet në sektorin e shëndetësisë, veçanërisht në procesin e prokurimit dhe transparencës së këtyre aktiviteteve.

Ministria e Shëndetësisë duke u përkushtuar në zbatimin e legjislacionit dhe në aktivitetet që adreson Planin e Integritetit Institucional ka emëruar edhe mekanizmat, që kanë për detyrë mbikëqyrjen e këtij procesi, raportimin e tyre te akterët kompetent, respektivisht eliminimin e rreziqeve të mundshme në bazë të të gjeturave përgjatë procesit të mbikëqyrjes.

Zbatimi i Planit të Integritetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 dëshmon përkushtimin institucional për të mbështetur qeverisjen e mirë në sektorin e shëndetësisë. Progresi i deritashëm është i qartë, ndërsa mbeten të domosdoshme përpjekje shtesë në aspektin e zbatueshmërisë teknike, mbështetjes njerëzore dhe përmirësimit të infrastrukturës digjitale.

II. Analiza e realizimit të planit të integritetit

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2025, Ministria e Shëndetësisë ka vazhduar zbatimin e Planit të Integritetit Institucional 2024-2026. Planin ka për qëllim forcimin e mekanizmave institucional për parandalimin e korrupsionit, përmirësimin e transparencës dhe rritjen e llogaridhënies.

Janë trajtuar shtatë fusha të rrezikut me gjithsej 57 masa të planifikuara. Nga këto:

- 40 masa janë realizuar plotësisht (70%),

- 13 janë realizuar pjesërisht (23%),
- dhe 4 masa mbeten të parealizuara (7%).

Zbatimi është përcjellë përmes mbledhjes së të dhënave nga përgjegjësit për çdo masë dhe analizës së dokumenteve përkatëse të brendshme. Progresi i arritur pasqyron një angazhim institucional aktiv për rritjen e integritetit në të gjitha nivelet.

III. Realizimi i aktiviteteve

Në fushën e planifikimit dhe menaxhimit financiar janë realizuar masa për hartimin dhe zbatimin e planit të prokurimit, barazimin ditor të të dhënave financiare dhe raportimin për penalitetet. Janë hasur sfida në ritmin e shpenzimeve për shkak të vonesave administrative dhe ndryshimeve të paparashikuara në planifikim.

Në fushën e burimeve njerëzore është ruajtur zbatimi i parimit të meritës, janë organizuar trajnime të rregullta për stafin dhe është bërë zbatimi i politikës për deklarimin e konfliktit të interesit. Gjatë periudhës raportuese është raportuar një rast i deklaruar konflikti.

Komunikimi institucional është përmirësuar përmes takimeve të rregullta të menaxhmentit dhe publikimit të të dhënave në uebfaqe. Raporti për zbatimin e Planit të Integritetit është publikuar dhe PSO për komunikimin është në zbatim.

Sa i përket sistemit të të dhënave dhe informatave shëndetësore, janë ndërmarrë hapa në zhvillimin dhe trajnimin për përdorimin e moduleve të SIS dhe SMSF, përfshirë takimet dhe trajnimet me IKSHPK dhe institucionet shëndetësore. Mbeten sfida të ndërlydhura me mungesën e resurseve humane dhe teknike.

Në fushën e prokurimit, janë publikuar të gjitha dokumentet përmes platformës elektronike, ndërkohë që janë marrë masa ndëshkuese për vonesat nga operatorët ekonomikë. Një aktivitet për trajnimin e menaxherëve të kontratave nuk është realizuar gjatë kësaj periudhe.

Në aspektin e furnizimit me barna, janë bërë përpjekje për planifikim më të mirë përmes SMSF-së dhe janë lidhur kontrata për produktet e listës esenciale. Ka pasur sfida me mungesën e ofertave dhe procedurat e zgjatura të ankesave në OSHP, çka ka ndikuar në ritmin e furnizimit.

Në fushën e inspektimeve janë realizuar aktivitete të rregullta nga inspektoratet përkatëse. Është finalizuar projektligji për Inspektoratin Qendror Shëndetësor dhe është angazhuar një zyrtar ligjor. Pavarësisht kësaj, mungesa e kapaciteteve profesionale dhe teknike vazhdon të mbetet sfida.

IV. Sfidat

Gjatë periudhës raportuese janë identifikuar këto sfida kryesore:

- mungesa e burimeve humane profesionale në disa fusha kyçe,
- vonesa në miratimin e dokumenteve ligjore dhe strategjike,
- probleme me rrjetin qeveritar dhe funksionalitetin e moduleve digjitale,
- tej zgjatje e procedurave të prokurimit dhe ankesave në OSHP.

V. Rekomandime

Për të përmirësuar më tej zbatimin e Planit të Integritetit, rekomandohet:

- forcimi i përgjegjësisë institucionale dhe mbështetja me staf të kualifikuar,
- trajnime të vazhdueshme për zyrtarët në fusha të ndjeshme,
- përsheptimi i zhvillimit dhe ndërlidhjes së sistemeve SISH dhe SMSF,
- komunikim më i ngushtë me OSHP-në dhe publikun për çështje kritike si furnizimi me barna.